



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF
KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPAL GJILAN /
GILAN BELEDIYESI



NJOFTIM

Më datë 21.11.2025, në ora 09:00, Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, në përbërje të plotë:

- Ali Arifi – kryesues
- Ali Morina – anëtar
- Bejtullah Krasniqi – anëtar
- Ahmet Daku – anëtar
- Driton Sylejmani – anëtar

ka mbajtur mbledhjen emergjente për analizimin e gjendjes së krijuar pas reshjeve të shiut të datës 18 nëntor 2025.

Në mbledhje u konstatua se:

Edhe pse Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Gjiçanit, paraprakisht dhe në mënyrë të përhershme, ka qenë e angazhuar në pastrimin e shtretërve të lumenjve dhe përrenjve, eliminimin e fytave të ngushtë (aty ku ka qenë e mundur), si dhe ka intervenuar pandërprerë përmes ekipeve emergjente gjatë reshjeve, megjithatë intenziteti i lartë i reshjeve ka bërë që lumenjtë të dalin nga shtrati, duke shkaktuar dëme në ekonomitë familjare dhe bizneset.

Komisioni, unanimisht, mori vendim që menjëherë të dalë në terren, t'i evidentojë dhe më pas t'i vlerësojë dëmet e shkaktuara.

Për vlerësimin e dëmeve është e domosdoshme që pronarët e ekonomive familjare dhe subjektet afariste, të cilët kanë pësuar dëme nga reshjet e shiut të datës 18 nëntor, të paraqesin kërkesë drejtuar Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, në Qendrën për Qytetarë të Komunës së Gjilanit.

Afati i aplikimit: nga 24.11.2025 deri më 08.12.2025.

Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Kërkesa drejtuar Komisionit;
2. Fotografi të objekteve ku është shkaktuar dëmi;
3. Adresa e saktë e objektit/objekteve të dëmtuara;
4. Numri i telefonit të aplikuesit;
5. Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit.

—

Më: 21.11.2025

Gjilan

Kryesuesi i Komisionit:

Ali Arifi